

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME

"OST SECURITY" SH.A

Sot, më datë 30/11/2010, në Tiranë, Shqipëri, në mbështetje të ligjit nr, 9901 datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjit Nr.8770 datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", u hartua ky akt themelimi nga Z. Sokol Ramadani, Administrator i OST sh.a, si përfaqësues i Aksionerit të vetëm , OST sh.a., si më poshtë vijon:

Neni 1 Themelimi dhe emri i shoqërisë

Krijohet shoqëria anonime e ruajtjes dhe sigurisë fizike "OST SECURITY" sh.a. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

Sella e shoqërisë është në Bulevardin "Gjergj Fishta", Tiranë Shqipëri. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri anonime pa Oferte Publike.

Neni 2 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kompanisë është pa afat të caktuar.

Neni 3 Objekti i shoqërisë

Objekti i shoqërisë është:

- a. Sigurimi dhe ruajtja e objekteve në pronësi dhe administrim të OST sh.a. Shoqëria mund të sigurojë dhe ruajë edhe objekte në pronësi apo administrim të shoqërive ku OST sh.a. është aksioner i vetëm.
- b. Sigurimi dhe mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të personave, në funksion të realizimit të shkronjes 'a'.

Shoqëria ushtron veprimtarinë për kategorinë a+b sipas përcaktimeve të ligjit Nr.8770 datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike" dhe si e tillë mund të shtrijë aktivitetin e saj në të gjithë territorin Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licensave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj për të cilat kerkohen këto dokumenta administrative.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë në kuptimin e zgjerimit apo ngushtimit të atij ekzistues, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme duke ruajtur në momentin konkret përshtatjen me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 4

Kapitali Themeltar dhe Aksionet

Kapitali themeltar i shoqërisë është 4,000,000 (katërmilion) lekë dhe është i ndarë në 4,000 (katërmijë) aksione me vlerë nominale 1,000 (njëmijë) lekë secili. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht nga aksioneri i vetëm, OST sh.a.

Aksionet janë të formës nominale dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

- a) Aksionari përgjigjet për humbjet e shoqërisë ndaj të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e shoqërisë.
- b) Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo të zvogelohet, në mënyrën dhe formën e parashikuar me ligj.

Neni 5

Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të "OST SECURITY" sh.a. janë :

1. Këshilli Mbikqyrës;
2. Administratori.

Neni 6

Perberja e Këshilli Mbikqyrës

Anëtarët e Këshilli Mbikqyrës të shoqërisë janë:

1. Engjell zeqo
2. Skender Madani
3. Ilir Kurti

Neni 7

Administratori

Shoqëria adminis trohet nga Administratori i cili zgjidhet nga Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e tij të parë.

Administratori i parë i shoqërisë është z. Arben Çela.

Neni 8

Drejtuesi teknik

Shoqëria ka në përberje të saj një drejtues teknik, i cili është përgjegjësi ligjor për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike sipas parashikimeve të ligjit Nr.8770 datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike".

Drejtuesi teknik emërohet dhe shkarkohet nga Keshilli Mbikqyrës.

Drejtuesi i pare teknik eshte z. Nesim Ndreu.

Neni 9
Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrulli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Eksperti i parë kontabël i shoqërisë do të jetë:

1. Shpresa Breçani

Neni 10
Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Shoqëria publikon çdo tre-mujor të vitit raporte ndërmjetës financiare të pa-audituar përveç tre-mujorit që përfundon me raportin e audituar.

Përrjashtim bën ushtrimi i parë financiar që fillon në ditën e regjistrimit të Shoqërisë dhe përfundon më 31 dhjetor 2010.

Ky akt themelimi i shoqërisë Anonime përplohet në 5 (pese) kopje në gjuhën shqipe.

PER AKSIONERIN

ADMINISTRATORI I OST sh.a

Sokol Ramadani

